



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
KRYESIA

Pogradec, më 24.06. 2026

VENDIM

Nr. 18 Datë 24 /06 /2026

MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN JASHTË RADHE.

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Martë , më datë 30.06.2026, ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec, zhvillohet mbledhja e rradhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr.40, datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

- 1. Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
- 2. Projekt – Vendim :** Miratimi i Procesverbalit të datës 09.06.2026.
- 3.** Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës.
- 4.** Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 09.06.2026.
- 5. Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Maj 2026.
- 6. Projekt – Vendim:** Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec (faza1).
- 7. Projekt – Vendim:** Ndryshimin e Vendimit nr. 33 datë 30.03.2026 të Tavanëve Përgatitore të Projekt Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec.

- 8. Projekt – Vendim:** Miratimin e përfundimit të procedurave të privatizimit të banesave, të cilat kanë mbetur pa u regjistruar në agjencinë shtetërore të kadastrës për lidhjen e kontratave para noterit.
- 9. Projekt – Vendim:** Për akordimin e ndihmës financiare znj. Aspasia Vako, Lagjia 5, Bashkia Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit.
- 10. Projekt – Vendim:** Për akordimin e ndihmës financiare znj. Hysnje Sadikaj, Bucimas, Bashkia Pogradec, për shkak të dëmtimit të banesës nga rënia e zjarrit.
- 11. Projekt – Vendim:** Përdorimin për nevojat e enteve të Bashkisë të sasisë së materialit drusor të sekuestruar.
- 12. Projekt- Vendim:** Për një rishpërndarje në VKB nr 128, datë 22.12.2025, “ Miratimin dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Pogradec për viti 2026”.

Ngarkohet Sekretarja e Këshillit , në mungesë Kryetarja e Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes në mediat sociale, lokale dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës për cdo këshilltar, te kryetari I Bashkisë Pogradec, Deputetët e Bashkisë Pogradec dhe personat apo dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te kryetari I Bashkisë Pogradec.

PËR KRYESINË E KËSHILLIT

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

